

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1933 Prot

Durrës, më: 27.08.2025

V E N D I M
Nr. 71, datë 27.08.2025

PËR

**"OFRIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE, BACHELOR, NË "MENAXHIM TURIZËM" ME PROFIL
"MENAXHIM HOTEL RESTORANT", NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të VKM-së Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 për "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; të Udhëzimit Nr. 01, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" i ndryshuar; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, si dhe bazuar në shkresën me Nr. 1832/1 Prot., datë 25.08.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, vendimi Senatit Akademik nr.88, datë 25.08.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze të programit të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, në "Menaxhim Turizëm" me profil "Menaxhim Hotel Restorant", me 180 kredite, pranë Departamentit të Turizmit në Fakultetin e Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

2. Tarifa për këtë program studimit do të jetë 25.000 lekë

Kodi i Programit: 63BA1013 A

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- ✓ Administratori
- ✓ Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Ada ALIAJ

